



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

Nr. 271/1 Prot.

Vlorë, më , 11.02.2021

VENDIM

NR. 5, DATË 11. 02. 2021

PËR

**"MASAT E MARRA NGA UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE, PËR
FILLIMIN DHE PËRFUNDIMIN E SEZONIT TË PROVIMEVE TË SESIONIT TË
DIMRIT PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021"**

Bazuar në Nenin 3 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të Ligjit Nr.15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", referuar situatës së krijuar dhe në zbatim të protokolleve shëndetësore anti Covid - 19, në mbledhjen e dates 11.02.2021, Rektorati,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e lëndëve, provimet e të cilave do të zhvillohen online, të paraqitura nga Fakultetet dhe dërguar në MASR. (Lista bashkëlidhur këtij vendimi). Nëse për arsye të ndryshme akademike do të ketë ndryshime në ndonjë lëndë, ndryshimi do të bëhet me miratimin e Dekanit.
2. Të miratojë listën e lëndëve, provimet e të cilave do të zhvillohen në auditor, sipas listës së dërguar më parë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.(Lista bashkëlidhur këtij vendimi).
3. Sezoni i provimeve për sesionin e dimrit për vitin akademik 2020 - 2021 në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë do të fillojë në datën 15 Shkurt dhe do të përfundojë në datën 10 Prill 2021.
4. Për të gjitha provimet që do të zhvillohen në auditor të respektohen të gjitha rregullat e protokollit shëndetësor Covid-19.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

5. T'i sugjerojë Senatit Akademik ngritjen e komisionit ad-Hoc, me përbërje: Prof. Xhiljola Agaraj (kryetare, anëtare e SA), Prof. Frosina Londo Qyrdeti (anëtare, anëtare e SA), Prof. Denada Kasemi (anëtare, anëtare SA), i cili do të hartojë për Senatit Akademik një relacion mbi plotësimin ose jo të kriterëve të kandidaturave për Administrator të UV-së.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI

